2. Përveç kriterëve të mësipërme në përcaktimin e vlerës së tokës tjetër që nuk është tokë bujqësore, pyjore dhe ndërtimore, merren parasysh edhe kritere të tjera si kushtet mjedisore dhe kushtet e terrenit, nëse këto të fundit kanë një ndikim të dallueshëm në vlerësimin e pronës së paluajtshme.

V. KONKLUZIONI

Për përgatitjen e këtij raporti është bërë inspektimi i pronës por nuk është kryer një mbikqyrje strukturore, si dhe në mungesë të të dhënave në elaborat nuk jemi në gjendje të raportojmë nëse prona ka ose jo difekte strukturore.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MF - Nr. 02/2015 Për Miratimin e Metodave dhe Kriterëve Teknikë të Vlerësimit për Përllogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet, dhe Dëmeve që kanë të Bëjnë me Shpronësimin, vetëm në rastet kur në rajonin ku parashikohet të ndodhë shpronësimi për interes publik, mungojnë treguesit e shitblerjes, apo ka të dhëna të besueshme se këta tregues janë abusive dhe jo real, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim mund të marrë të dhëna të nevojshme shtesë nga subjektet e listuara në nenin 16, paragrafi 2 dhe 3 i këtij udhëzimi.


Përkufizimi i "vlerës së tregut" është:

"Vlera e tregut të pronës së paluajtshme nënkupton shumën e përafërt të vlerësuar për të cilën një pronë do të shkëmbehet në datën e miratimit të vendimit për autorizimin e kryerjes së punëve përgatitore ose në datën e paraqitjes fillestare të kërkesës, mes një shitësi dhe blerësi të vullnetshëm, përmes një transaksioni ku ata nuk kanë lidhje me njëri tjetrin, dhe pasi të jetë bërë marketingu i duhur ku secila nga të dyja palët ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme, me maturi dhe pa ndonjë detyrim".

Opinionimi për Vlerën e pronës së paluajtshme që është objekt i këtij vlerësimi, në përputhje me përkufizimet, analizat, dhe supozimet e më sipërme është:


NUMRI I PRONËS	SIPËRFAQJA PËR VLERËSIM m ²	ÇMIMI PËR €/m ²	VLERA E PRONES €
541-2	55 m ²	260.00€	14,300.00€

Zyrtarët e DVPPSHK-së:


1.  Numri i licencës_VP026

2.  Numri i licencës_VP099

Udhëheqësi i DVPPSHK-së:

 Numri i licencës_VP004

U.D Drejtoreshë e DVPP-së





Aktit të vlerësimit i bashkangjiten dokumentat e mëposhtme:

1. Fotografitë e pronës së paluajtshme/zonës përreth
2. Dokumentacioni harto grafik, që përbëhet nga plani përkatës kadastral dhe harta e parcelës përkatëse;
3. Pjesa grafike e pronës dhe sipërfaqja që këmbëhet;
4. Dokumentat e pronësisë.

Përgatitur nga Eksperti i Gjeodezisë:









Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živine Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

Zyrtarisht

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71006024-00541-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 11-1320-24-2

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 22.04.2024 - 09:08

Komuna / Opština / Municipality: KLINË / KLINA / KLINĚ

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Klinë / Klina / Klině

Zyra Kadastrale Komonale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KLINË / KLINA / KLINĚ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71006024-00541-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	340	20-1996		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place FSHATI	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
--	---	---	---	----------------------------------

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosar/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 3/Pashnjak 3 Klasse/3rd Class Pasture	340

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësi të adresës Pojednosto adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Klinës	600219366	/ / /		ABEDIN REXHA	1/1	20-1996	





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: KLINË

Nr. i njësish kadastrale / Br. katastarske jedinice: 541-1, 541-2


Zona kadastrale / Katastarska zona: KLINË

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësish kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: PARCELE

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500

MANUAL GJEODEZIK - PROPOZIM PER KEMBIM



Nr	Y	X	H	Kodi	Përshkrimi	Burimi
1	7465123.129	4720071.168	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
2	7465124.319	4720069.946	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
3	7465128.825	4720067.492	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
4	7465109.899	4720045.410	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
5	7465101.399	4720039.360	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
6	7465121.079	4720015.121	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
7	7465128.019	4720018.810	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
8	7465129.129	4720017.400	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
9	7465127.689	4720016.590	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
10	7465118.739	4720011.451	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
11	7465109.108	4720008.871	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
12	7465101.418	4720007.431	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
13	7465094.404	4720007.103	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
14	7465081.864	4720026.066	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
15	7465064.927	4720047.807	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
16	7465067.835	4720049.446	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
17	7465072.248	4720055.570	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
18	7465112.140	4720067.799	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
19	7465080.395	4720064.831	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
20	7465088.944	4720069.073	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
21	7465103.410	4720075.131	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
22	7465110.995	4720074.804	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
23	7465122.133	4720072.191	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
24	7465108.460	4720072.539	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
25	7465117.509	4720012.906	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM
26	7465107.863	4720010.263	0	2	Kunjë - shtyllë metalik	KM

Rilevoi / Snimio: BURIM HALILAJ
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ imi e prezime gjeodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 195

Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i përsorit zyrtar/ ime e prezime shërbëtorit)

V.V.

Nënskrimi / Potpis: _____

Nënskrimi / Potpis: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 29.03.2024

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____





Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. _____ 2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës mbajtur me datë 26. 07. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje; Kryetari i Komunës z. Zenun Elezaj, nënkryetarja znj. Marqe Selmanaj, drejtorët e drejtorive, Komandanti i policisë në Klinë, media lokale, anëtarët e kuvendit, qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti gjithë të pranishmit. Kryesuesi konfirmoj se prezent janë 23 anëtarë të kuvendit. Para rendit të ditës fjalën ja kaloi drejtorit të Gjeodezisë dhe kadastrit.

z. Nikson Dakaj, drejtor i Kadastrit: Përshëndetje të gjithëve. Kërkoj nga ju që ta largoni nga rendi i ditës pikën 4 pasi që mungon dokumentacioni. Ne kemi parashtruar kërkesën ministrisë, një kërkesë paraprake për shkëmbim të pronës por përgjigja e tyre akoma nuk ka ardhur prandaj kërkoj që të largohet kjo pikë e rendit të ditës.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje. Kërkoj që të hiqet pika e rendit të ditës: Shqyrtim i procesverbalit të takimit të kryetarit me qytetarë datë 25. 06. 2024 . Arsyet janë sepse nuk janë përfshirë në procesverbal diskutimet e disa të pranishmëve. Kërkoj që të shkruhen në procesverbal diskutimet e të pranishmëve shembull diskutimi i z. Berisha nga Dogujeva i cili ka folur pesë herë.

z. Zafer Gashi kërkoj që të vendoset pikë e re në rend të ditës ajo për zgjedhjet e këshillave lokale. Të diskutohet rregullorja dhe problematikat rreth këtij procesit. Ai foli tutje për problemet që kanë dalë gjatë këtij procesi dhe kërkoj që të ndryshon rregullorja.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne kemi biseduar me drejtorin e administratës dhe ka mbetur që të bëhet një raport i përgjithshëm dhe të vije në kuvend.

z. Esat Raci: Përshëndetje. Kam obligim që të ju njoftoj se Besiana Gashi dhe Kushtrim Haliti më kanë ngarkuar që të ju njoftoj se janë jashtë vendi dhe nuk mund të marrin pjesë në këtë mbledhje. Sa i përket rendit të ditës për pikën Pyetje dhe Përgjigje sa mbaj mend keni

pas thënë që të kalon në pikën tretë në radhitje ndërsa nga Ekzekutivi na është thënë se në këtë seancë ose në seancën e radhes të na vije lista e pronave të uzurpuara.

z. Fadil Gashi, kryesues: Besoj se në seancën e shtatorit do të vije lista e kërkuar.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje. Pika 9 në lidhje me procesverbalin ,, shqyrtimin e tij nuk ka pse të hiqet sepse është vetëm shqyrtim dhe jo edhe miratim.

z. Fadil Gashi, kryesues: Saktësisht ashtu. Unë s` di edhe pse duhet ta shqyrtoj kuvendi takimin me qytetarë. Përveç kësaj atë ditë janë mbajtur dy takime një pas një me qytetarë. Dhe ka mundësi që i kanë ngatrruar, zotëria në fjalë ka folur në takimin e dytë dhe jo në takimin me qytetarë. Pika 9 mbetet. Kemi një propozim që të hiqet pika 4. Kush është PËR?

Me 21 për, dy abstenime(LVV), asnjë kundër u MIRATUA.

Pika 1. Arsytim i mungesave.

Kryesuesi tha se ka njoftim për mungesë nga Besiana Gashi, Florentina Berishën dhe Kushtrim Haliti që mungojnë me arsye.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Zafer Gashi: Në proces është shkruar mirë. Ju kisha lutë kryesues që kur një asamblist ose një grup asamblistësh dalin nga salla nuk është mirë që të diskutohen kur nuk janë prezent. Arsyeja pse ne kemi dalë nga mbledhja ka qenë arsye politike dhe e kemi sqaruar dhe nuk është mirë që të na quajnë veprimin si viktimizim.

Me 21 për, dy abstenime(LVV) asnjë kundër U MIRATUA.

Pika 3 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Rekomandimet e KPF-së me 23 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për suspendimin e vendimit të miratuar për rregulloren për taksa.

Kryesuesi i Kuvendit tha se akoma janë duke pranuar konfirmime të ministrive të tjera dhe në momentin që ekzekutivi e kompletton këtë rregullore atëherë do të vijë në kuvend për të marrë vendim .

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u suspendua vendimi

Pika e 5 e Rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-qershor 2024

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Në radhë të parë dua ta falënderoj edhe një herë asamblenë për aprovimin e buxhetit pothuajse me vota unanime. Kemi dhënë garanci se realizimi i këtij buxheti do të jetë krejt ndryshe nga vitet e kaluara.

Është një buxhet që është realizuar dhe shfrytëzuar më së mirë gjatë këtij 6-shtë mujori të parë.

Drejtori i Financave ,z. Berisha foli për shpenzimet e buxhetit gjatë këtij gjashtë mujori . Përmendi shpenzimet në detaje nëpër të gjitha kategoritë duke theksuar se krahasuar me vitin e kaluar shpenzimi i buxhetit është shumë më i madh. Është realizuar qysh është planifikuar dhe votuar, tha z. Berisha duke e përmbyllur se është një vlerësim i ardhur që Komuna e Klinës është radhitur si një nga komunat që është rritur me pikë më së shumti nga komunat e tjera sa i përket transparencës.

z. Ndrec Zefaj: Përshëndetje për të gjithë. Lidhur me pikën që po e shqyrtojmë, e përcjella me vëmendje fjalën e drejtorit dhe me disa konstatime pajtohem në lidhje me realizimin e buxhetit krahasuar me vitin 2023 por këtë vit kemi një performancë më të dobët sa i përket të hyrave vetanake. Kur të marrim parasysh edhe të hyrat nga grandit qeveritar të cilat sipas ministrisë do të kemi më pak shkakun i numrit të banorëve, shtoj këtu edhe këtë realizim më të dobët nga të hyrat vetanake, mund të themi se gjithashtu vitin e ardhshëm do të kemi tkurrje të buxhetit, buxhet më pak.

z. Zefaj kërkon sqarim për disa kode nga lista e shpenzimeve siç është shtesa për të zgjedhurit, shërbimet e veçanta dhe tranfere për përfitues individual.

z. Zafer Gashi: Kam një informacion, a kanë filluar përsëri punimet tek Gremniku sot, dua të dija nëse ka informacion ekzekutivi, kryetari për këtë punë?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Kryetari nuk ka asnjë informacion. Leja për ndërtimin e fabrikës së çimentos është e pezulluar dhe nuk guxon askush që të punoj në atë drejtim.

z. Zafer Gashi: Sikur të gjithë të tjerët që e kanë shqyrtuar materialin në lidhje me buxhetin, kam edhe kritika edhe lëvdata. Transparenca ka të bëjë me punën e kuvendit dhe jo të ekzekutivit. Shikoj i kë indikatorët aty. Ju kisha lutë që të përgjigjeni: Tek të hyrat vetanake shihet që ka rënie. Përcjellën ato shuma gati çdo gjashtë mujor, me vite, 151 mijë kujdestari, punë gjatë natës , punë jashtë orarit, na e sqaroni kush janë paguar? 157 mijë euro të tjera të na sqarohen a janë mjete të marruara nga përmbaruesit, tek kodi 14. Tek kodi 17 udhëtimet jashtë vendit. Kodi 24 shpenzimet e veçanta, kodi 26 shpenzimet kontraktuese të tjera. Tek 29 shpenzimi për anëtarësim nuk dihet për çka. Mirëmbajtja e mobileve si gjithmonë janë shpenzime të shumta dhe nuk është sqaruar as herën e kaluar.

z. Zafer Gashi kërkon sqarim edhe për karburantet për vetuar dhe kërkon listën se cila drejtori ka harxhuar më shumë karburante duke thënë se kemi fakte se edhe gjatë vikendeve drejtorët marrin veturën zyrtare dhe e shfrytëzojnë. Kërkon gjithashtu sqarim edhe për shpenzimin për mirëmbajtjen e veturave. Në fund kërkon shpjegim për kodin 74 se kujt ja aknë dhënë mbi 200 mijë euro, transferë për përfitues të tjerë.

z. Esat Raci: Kam tre pyetje për drejtorin e financave. Numri 29 edhe për mua është e paqartë. Numri 31, shumë shqetësuese është për mua. A është zhvilluar ndonjë procedurë për këtë shumë prej 61 mijë euro. Në tabelarin tim nuk figurojnë shpenzimet për dreka.

z. Valmir Bacaj: Sa i përket raportit për këtë periudhë ne e kemi studiuar raportin dhe sa i përket kategorive të të hyrave dhe shpenzimeve ka një trend pozitiv.

z. Bacaj bëri një krahasim të viteve 2017-2023 dhe në për kategori bëri krahasime duke konstatuar se edhe të hyrat vetanake edhe shpenzimet edhe buxheti në vitin 2023 krahasuar me atë 2017 është i trefishuar prandaj tha z. Bacaj se jemi shumë të kënaqur me rrjedhjen e parasë publike në këtë periudhë kohore dhe qeverisjen lokale.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Tek planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake nuk jemi mbrapa për këtë vit ka ndodhë zbritja e tatimit në pronë për 30%. Ju siguroj sot se s' ka nevojë që të shqetësohet askush sepse do ta realizojmë dhe tejkalojmë planin e realizimit. Tek çështja e shpenzimeve të veturave dhe servisimi i tyre. Ne duhet ta dimë që edhe inventari edhe veturat çdo ditë e më shumë amortizohen prandaj është servisimi. Nuk mund ta dimë se kur priset vetura. Sa i përket derivateve, sa më shumë që punohet edhe shpenzimet e derivateve janë më të mëdha. Të jemi korrekt në çështje që nuk varen të gjitha nga ne. Sa i përket kujdestarisë gjatë natës, punët shtesë, pagesat për mirëmbajtje të qytetit, kujdestaritë në QKMF etj. Janë këto pagesa shtesë që kërkuat sqarim. Pagesat për vendimet gjyqësore janë pagesat për mësimdhënësit, janë pagesa që jo vetëm Klina por asnjë komunë nuk mund të ju ikë sepse janë obligime nga kontrata kolektive. Shpenzimet për udhëtime jashtë vendit , njëra nga to është ajo që kemi qenë në Kroaci si kuvend të gjithë ne, si dhe vizita zyrtare në Itali. Pagesat për shërbime të veçanta janë shërbimet konsulentë. Edhe sigurimi fizik i objekteve institucionale, edhe servisimi i kompjuterëve, blerja e pajisjeve të reja janë pagesat që kërkuat sqarim. Për 200 mijë eurot që u përmend fjala është për subvencionimin e bujqve. (pas përsëritjes së kërkesës për sqarim nga z. Esat Raci, fjalën e morri kryetari i komunës).

z. Zenun Elezaj, kryetar: Tek nr. 29 është anëtarësia për asociacion dhe është vlera 5774 euro. Tek 62, është shpenzimi për blerjen e inventarit- furnizim në drejtorinë e kulturës, në shkolla etj. Vlera prej 200 mijë euro është pagesat për subvencionet e bujqve, shpërblimet e festivalit, bursat e nxënësve dhe shpenzimet për lindjet, vdekjet dhe për varrimet(pagesa individuale). Pagesat për të zgjedhurit- fjalën e merr zyrtarja e financave.

Znj. Melihate Behramaj, Zyrtare financiare: Pagesat shtesë për të zgjedhurit janë pagesat për anëtarët e komiteteve- ato organe të kuvendit që paguhen përmes listës së pagave. Tek drekat zyrtare, ato nuk quhen më dreka zyrtare por përfaqësim zyrtar dhe është kodi i njëjtë 14310.

z. Zafer Gashi: Kryetari dhe drejtori tha se tek shpenzimet për varrime por shuma është zero për 6- mujorin e parë. Unë pres shumë më shumë nga ju i nderuar drejtor , nga drejtorja e juaj. Unë i kam indikatorët e transparencës këtu , lexoj të lutem dhe shihe se a kanë të bëjnë me ekzekutivin apo kuvendin.

z. Ndrec Zefaj: Atë që e përmendi drejtori në lidhje me të hyrat vetanake të komunës, ai tha se kjo gjendje është si shkak i zvogëlimit prej 30% , nuk është vetëm kjo , janë edhe kodet e tjera ekonomike. Gjobat nga trafiku ne i marrim këto të hyra. Pikë tjetër, u tha se jemi afërsisht 1 milion të hyra por të flasim me shifra, janë 880 mijë euro, na duhen edhe 120 mijë

që të vijmë tek ajo shifër që e përmendi drejtori. Nuk jemi të predispozuar që të kritikojmë por të jemi realist.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Unë, z. Zefaj nuk kam harruar as vitin e kaluar çfarë ke thënë. Vitin e kaluar ke shprehur dyshimin se a do ta realizojmë buxhetin shkaku se fillimi i atij viti ka qenë me i mangët sa i përket shpenzimeve. Është zor të pranohet edhe rezultati i mirë. Pse nuk po thua që vitin e kaluar e kemi realizuar 430 mijë euro më shumë se sa planifikimi që ka qenë. Edhe këtë vit do ta arrijmë realizimin e planifikimit. Unë flas me shifra jo me hamendje. Gjithmonë fillimet e viteve janë më të zorshme sepse nuk janë diaspora këtu të cilët e rrisin tatimin në pronë dhe të tjerat. Ju siguroj që realizmi i buxhetit për këtë vit do të jetë afër 100%. Kemi filluar me shpërndarjen e njoftimeve për biznese për tatime. Ata që nuk i përgjigjen dhe nuk kryejnë obligimin do të shkojnë në përbarim, jemi të obliguar sipas auditorit gjeneral.

z. Ndrec Zefaj: Kur bëhet fjalë për paranë publike normalisht që shqetësohem, do të duhej çdo anëtar i kuvendit të shqetësohet për parat e taksapaguesve. Arsye janë shifrat më të ulta që janë prezantuar. Të hyrat janë më të vogla se sa vitin e kaluar, ky është shqetësim i imi. Shpresoj që të tejkalohet 5 herë më shumë, unë do të ndjehesha shumë mirë.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Unë e pashë shqetësimin e opozitës por opozita për këtë punë është në kuvend. Dy gjera i shoh këtu: Pagesat shtesë të cilat më gëzojnë sepse qyteti është më i pastër . Tek tatimi në pronë, faleminderit drejtor sepse prej ardhjes tuaj në krye të drejtorisë arkëtimi i tatimit në pronë është shumë më mirë. Veturat dhe servisimi i tyre, të gjithë kemi veturë në shtëpi dhe e dimë se sa na kushton mirëmbajtja e saj. Ndërsa për shpenzimet e derivateve-sa më shumë që punohet aq më shumë shpenzohet.

z. Esat Raci: Për fund: Mirë është që punohet por një të gjithë e dimë se qytetarët e komunës janë duke bartur ujë me cisterna, nuk kanë ujë të pijshëm.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Klinës për vitin 2023.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Të gjithë e keni marrë këtë raport të auditorit të jashtëm. Bazuar në këtë vlerësim të auditorit dua të falënderoj të gjithë zyrtarët komunal të cilët e kanë kryer me përkushtim punën. Auditori më ka thënë se dy gjera e dallojnë komunën e Klinës nga Komunat e tjera: 1. Bashkëpunimi shumë i mirë i brendshëm i stafit të komunës dhe 2. Përgjigjja ndaj kërkesave të auditorit e cila ndodhë shumë shpjet dhe korrekt. Nga ky auditim shihet që nuk ka asnjë shkelje ligjore, asnjë keqpërdorim i mjeteve. Ka vetëm çështje teknike. Është një nga raportet më të mira në nivel vendi që mund at këtë një komunë.

z. Esat Raci: Më emocionoj Enveri me vetlavdat që i beri. Dëshiroj shkurt vetëm dy rreshta nga të gjeturat e auditorit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si keq klasifikim i shpenzimeve, vlerësim i aplikacioneve të fermerëve në kundërshtim me thirrjet publike. Mua me vjen mirë që ne si opozitë vazhdimisht i kemi ngritur këto çështje dhe auditorët i kanë gjetur gjithashtu.

z. Zafer Gashi: Ai që nuk e lavdëron veten nuk e di çka është. Të gjitha institucionet duhet të punojnë mirë. Më të vërtetë shumë herë jemi ofenduar për rolin tonë opozitar por ajo që e kemi thënë po del e vërtetë. Kemi thënë që jeni duke shpërnda subvencionet në bujqësi jo në rregull. Janë shpërnda duke mos respektuar kriteret. Ju po i minimizoni por nuk janë të lehta të gjeturat si çështja B2, C1, B3, A1, B4, B5 etj. Këto janë disa që ju do ti përmirësoni shpresoj.

z. Valmir Bacaj: Pas raportit të performancës për komunë e Klinës nga KDI, ku Klina është radhitur e dyta në nivel Kosove për transparencë dhe e para me progresin më të madh, raporti i auditorit për vitin 2023 është një lajm tjetër i mirë për qeverisjen komunale të z. Elezaj. Mendoj që një opinion i tillë i pa modifikuar vjen atëherë kur vërtetohet një nivel i lartë i menaxhimit financiar, respektimin e kriterëve të prokurimit, dhe punësimit, kritere që në të kaluar ka pasur ngecje e që në këto 6 vite të qeverisjes Elezaj nuk janë përsëritur. Sigurisht kur s` ka gjetje të tjera përmenden edhe gjetjet siç janë ato të vonesave të pagesave por që kjo nuk varet nga ekzekutivi. Duhet theksuar se opinionin i pamodifikuar i auditorit për qeverisje të mirë hap rrugë edhe për përfitimin e grandeve. Ky është një nga 4 kriteret që kërkohen për fitimin e grandit komunal. Edhe tre kriteret e tjera tashmë janë përmbushur nga Komuna e Klinës dhe presim që të përfitohet grandin që vitin e kaluar na është pamundësuar. Ne si grup kuvendar e vlerësojmë raportin pozitiv të auditorit.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit.

Pika 9 e rendit të Ditës: Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i kryetarit të komunës me qytetarë

Pika 10 e Rendit të Ditës: Informatë nga drejtorja e arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2023-2024.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Përshëndetje të gjithëve. Viti shkollor 2023-2024 filloi me një shtator. Siç e dini vështirësia kryesore na erdhi nga ministria e arsimit rreth blerjeve të teksteve shkollore. Edhe në përfundim të vitit shkollor ka pasur nxënës që s` ka arritur që të i blej të gjitha tekstet mësimore. Drejtorja e arsimit në Klinë është e para drejtori që i ka furnizuar shkollat me tabela të mençura. Sfida kryesore që kemi pasur dhe do ta kemi edhe në vazhdimësi ka qenë dhe është kontrata kolektive. Tani mësimdhënësit e komunës së Klinës të vetmen zgjidhje e kanë përmes gjykatave pa dëshirën e tyre. Një problem tjetër gjatë gjithë kohës që kemi pasur shqetësim është zëvendësimi i mësimdhënësve. Për vitin 2023 kemi pasur një udhëzim nga ministria për mësimdhënësit e sëmurë me sëmundje kronike të cilët i ka liruar nga mësimdhënia por nuk ka nda buxhet për mësimdhënësit që do të i zëvendësonin. Drejtorja e arsimit gjatë këtij viti është munduar që të jetë afër nxënësve dhe mësimdhënësve. Më gëzon fakti se këtë vit kemi pasur rezultate të mira në testin e maturës. Jemi shumë më mirë se sa shumë komuna të tjera, diku mbi 74.83% në nivel komunal. Lenë për të dëshiruar testi i arritshmerisë ku nuk kemi dalur shumë mirë diku 50% ku në këtë drejtim drejtorja e arsimit do të angazhohen veçanërisht. Më lejoni që të i falënderoj të gjithë akteret e nivelit të arsimit që kanë bërë një punë të çmueshme.

Pika 11 e Rendit të Ditës: Informatë nga drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale lidhur me funksionimin e punës në QKMF.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Edhe unë sikurse drejtori i arsimit po e shfrytëzoj rastin që të i falënderoj stafin mjekësor, mjekët, teknikët etj. për të gjithë kontributin e vazhdueshëm që janë duke e dhënë që qytetarëve të Klinës të ju ofrojnë shërbime sa më të mira. Ka sfida por jo gjithçka varet nga ne. Ju e dini që shërbimet e kujdesit parësor mjekësor ofrohen bazuar në një udhëzim administrativ i aprovuar nga ministria e shëndetësisë. Kujdesi parësor shëndetësor është i obliguar që të punoj sipas këtij udhëzimi administrativ. Në seancën e janarit është aprovuar plani i punës së drejtorive. Në sferën e shëndetësisë objektiv kryesor ka qenë ofrimi i shërbimit shëndetësor dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve për të gjithë qytetarët. Në këtë periudhë kohore janar-qershor, në QKMF në QMF dhe AMF shërbime kanë kërkuar 49,631 qytetarë.

z. Bacaj në vazhdim përmendi veç e veç të gjitha shërbimet e dhëna në detaje. Ai tha se vetëm javën e fundit ka pasur një shpërthim të një pandemie dhe kanë qenë 1040 raste të trajtuara. Ai tha se një nga sfidat që ballafaqohet shëndetësia në përgjithësi është mungesa e barnave nga lista e barnave esenciale të cilën mungesë janë detyruar që ta plotësojnë. Po ashtu drejtori foli për vaksinimin e fëmijëve si dhe vështirësitë që kanë pasur rreth vaksinimin e vajzave kundër kancerit të qafës së mitrës ku ka pasur pak hezitim nga ana e prindërve. Ai tha se shpreson që prindërit do të vetëdijesohen për të mirën e fëmijëve të tyre. “Tani jemi në fazën e fundit të instalimit të pompave termike dhe gjatë dimrit do të kemi ngrohje përmes pompave termike dhe shpenzime më të vogla”, tha z. Bacaj.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Tek ngritja e kapaciteteve dhe resurseve njerëzore , drejtoria e shëndetësisë ka provuar vazhdimisht që të rekrutoj staf të ri ku javën e kaluar ka angazhuar 4 mjekë të rinj që kanë ndihmuar shumë në rritjen e ofrimit të shërbimeve shëndetësore ku tani do të ofrojmë shërbime mjekësore me ndërrime edhe në QMF dhe AMF ku ky shërbim ka ,munguar shkak i mungesës së mjekëve.

Në fund drejtori Bacaj bëri një falënderim publik për një donator i cili ka sjellë shtretër të rinj. Po ashtu falënderoj edhe asamblistin Tunë Dedaj për angazhimin në këtë drejtim. Ai tha se tani është blerë mamografi dhe se janë në fazën e vendosjes së pajisjeve që janë anti rrezatim dhe shpresojnë që nga shtatori të ofrohet edhe ky shërbim për nënat familjare.

Pika 12 e Rendit të Ditës: Informatë mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirave publike në Komunën e Klinës.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Përshëndetje të gjithëve. Informata mbi realizimin e planit mbi mirëmbajtjen e hapësirave publike. Drejtoria e SHPE është angazhuar në mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe zgjerimin e mirëmbajtjes se tyre.

Drejtori Millaku përmendi hapësirat të cilat mirëmbahen dhe tregoi që nga shkurti ka një marrëveshje me kompaninë “Ambienti”, një marrëveshje tre vjeçare për mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave të gjelbëruara. Synimi i jonë është që vit pas viti të rrisim hapësirat për mirëmbajtje, tha. Z. Millaku. Ai tha se në lidhje me shfrytëzimin e automjeteve zyrtare, të

shtunën me 22 qershor është shfrytëzuar makina zyrtare sepse kemi intervenuar në rrugë me zhavorr, po ashtu brenda ditës kemi intervenuar tek diga në Grabanicë. Ai tha se po ashtu të shtunën tjetër me 29 qershor është intervenuar në disa rrugë të cilat ai i përmendi me emër. Nëse dalim në punë thonë pse po dilni, nëse nuk dalim thonë pse s'po dilni, gjithmonë gjendet diçka për me ta mohu punën. Ne lëvdata nuk dua sepse ato i kemi marrë në 2021, për 4 vjet, e lëvdatat e tjera do të i marrim në 2025.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne nuk mund të i ndalojmë automjetet zyrtare se ashtu do të duhej të ndalen edhe ato të ndihmës së shpejt. Automjetet janë për punë edhe të shtunën edhe të dielën.

Pika 12 e Rendit të Ditës: Informatë nga zyra e prokurimit për punën e saj në periudhën janar- qershor 2024.

z. Labinot Morina, Zyra e prokurimit: Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket aktiviteteve të prokurimit për këtë periudhë, të planifikuara kanë qenë 120 procedura ndërsa deri me tani janë iniciuar 82 procedura- 68%. Kontrata të lidhura janë 65 kontrata ose 57% të punës vjetore. Në vlerë monetare deri me tani janë kontraktuar 3 milion e 360 mijë euro.

Pika 13 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje.

z. Binak Sylaj, drejtor i administratës: Përshëndetje të gjithëve. Bashkërisht kemi bërë një punë jashtëzakonisht të mirë atë të fillimit zgjedhjes së këshillave lokal. Nuk më pëlqeu ajo që tha anëtari i komisionit z. Zafer Gashi kur tha se nuk kemi qenë të përgatitur si komision. Kemi qenë të përgatitur shumë mirë edhe me datë 6 të muajit 7. Problemi ka qenë se ne kur kemi shkuar në oborr të shkollës kemi hasur në një masë të jashtëzakonshme. Ndoshta mos prezenca e policisë është shkak për z. Gashi thotë se nuk ishim të përgatitur. Dua të falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për punën e mirë të bërë. Unë konsideroj që është bërë një hap i mirë duke falënderuar edhe shoqërinë civile dhe uroj që po na dëgjojnë edhe qytetarët të cilëve ju bëjë thirrje të bëjnë kujdes që në të ardhmen të kë zgjedhin nëpër këto këshilla pasi që ata do të jenë përfaqësues të tyre dhe do ta ndihmojnë ekzekutivin që duke përfutur projekte në të mirë të vet qytetarëve. Ne fund të procesit ne do të punojmë një raport përfundimtar për komplet procesin e zgjedhjeve të këshillave.

z. Ndrec Zefaj: Meqenëse jam edhe unë pjesë e këtij komisioni. Pajtohem se kemi bërë një punë të mirë dhe transparente. Dilemat që ngriti Zaferi për kohën, mund ta bëjmë njoftimin dhe të ju lejmë dy orë në dispozicion qytetarëve. Qytetari edhe nëse jeton në Prishtinë ai ka të drejt të votoj në Klinë në zgjedhje lokale prandaj mendoj se ka të drejt të votoj edhe për bashkësi lokale. Mirë është të specifikohen këto dy çështje.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne nuk guxojmë të ndryshojmë rregulloren dhe të bijmë ndesh me udhëzimin administrativ.

z. Binak Sylaj, drejtor i administratës: Ka të drejt edhe Zaferi edhe Ndrecsa sa i përket përcaktimit të kohës- orës. Zgjedhjet në Ujmir ka qenë një proces i vazhduar nga data 6. Kemi filluar ditën e parë neve na u pamundësua në mungesë të policisë dhe qytetarëve. Ky ishte rast i veçantë por në vende të tjera nuk mund ta dimë se sa do të zgjasim pasi që

kandidatët për këshilla lokale ne i marrim nga masa e qytetarëve që propozohen. E kemi nisur mbarë dhe nuk guxojmë të i japim drejtim tjetër këtij procesi.

Znj. Marigona Racaj: Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Qytetarët e Siqevës po përballen me mungesë të ujit, kërkesa e tyre është që këto reduktime të minimizohen.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Faleminderit Marigonë. Sot kam marr informacionet për furnizimin me ujë gjatë muajit korrik. Me datë 15. 07. 2024 është ndërprerë furnizimi me ujë për 24 orë për fshatrat Gjurgjevik i vogël, Ujmir dhe Siqevë me qëllim të stabilizimit të rrjetit për linjat furnizuese për Shtupel, Kerrnicë, Dollc dhe Dresnik. Kjo është informatë zyrtare nga “Hidrodrini”. Nëse është e nevojshme unë do të jua jep disa informacione për muajin korrik se si ka qenë gjendja e furnizimit me ujë në Komunën e Klinës.

Në vazhdim drejtori z. Millaku lexoj shkresën komplet të dërguar nga kompania” Hidrodrini”, raport ky mbi furnizimin me ujë gjatë muajit korrik, të lagjeve dhe fshatrave dhe vet qytetit të Klinës.

Znj. Arta Pantina: Përshëndetje për të gjithë. Kam një pyetje për kryetarin. Pak më parë gjatë shqyrtimit të raportit të shpenzimeve u përmend se në shkollën fillore në Gllarevë “Dëshmorët e Qëndresës” është bërë furnizim me inventar. Dëshiroj të dijë se a është financim nga ndonjë organizatë apo nga Komuna dhe sa është shuma e financimit.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Unë e përmenda kategorinë e shpenzimeve por vlerën e saktë do ta thotë drejtori.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Renovimi i shkollës është nga programi IBA dhe ka vlerën prej 900 mijë euro. Pjesa e udhëtimit është mbuluar nga ne diku 60 mijë euro si dhe furnizimi me inventar po ashtu nga Komuna në vlerë prej 60 mijë euro të tjera.

Znj. Arta Pantina: Për drejtorin e Shërbimeve Publike, dëshiroj të dijë se cilat rrugë në Gllarevë janë rregulluar?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Rruga tek kryqëzimi kur kthehesh për Rigjevë dhe Zabërgjë si dhe rruga e varrezave. Po ashtu rruga e dytë posa ta kalosh pompën e derivateve në anën e djathtë.

Znj. Valmira Krasniqi: Kam një pyetje për drejtorin e DKA: Pse nuk është hapur konkursi për ndarjen e bursave për student?

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Tani në Tetor hapet konkursi dhe është dyfishuar numri i bursave.

z. Zafer Gashi: Kam një pyetje për kryetarin dhe drejtorin e DKA. U bënë tre muaj kur unë ju kam pyetur rreth dokumentacionit për ministrinë e infrastrukturës për banesat për çiftet e reja. Më keni thënë se për dy tre ditë do ta bëni aplikimin. A keni aplikuar? Po ashtu kam bërë pyetje për gurëthyesin në Sferkë dhe keni bërë udhëzimin për drejtorin e urbanizmit që

të hulumtoj dhe të na jep përgjigjen. A mund të na jepni sot këtë përgjigje. Për drejtorin e DKA: Sa duhet me pas nxënës në klasë sipas rregullores?

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Përshëndetje. Për banesë për çiftet e reja-banim kolektiv ka qenë kriter që të kemi parcelë ZB6, parcelë të tillë nuk kemi të lirë, pra ka pasur telashe me pronë. Pra ne duhet që ta planifikojmë një parcelë dhe duhet të kaloj në kuvend, kjo mund të bëhet vitin e ardhshëm.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Për gurthyes ka mbetur që drejtori i inspektoratit të mbledh informatat dhe besoj që i ka ato informata. Ne e kemi pasur një parcelë me planin zhvillimor por etazhiteti është i kufizuar dhe nuk mund të ndërtohet banesë 4 katesh. Me planin zhvillimor që do ta kemi ën shtator ta ngritim etazhitetin. Parcela të tjera nuk kemi pasur.

z. Faruk Smajli, drejtor i Inspektoratit: Përshëndetje të gjithëve. Po e nisi nga ajo që Zafer Gashi e tha më herët se kanë filluar punimet tek fabrika e çimentos. Unë i dërgova inspektorët dhe doli që është dezinformatë, nuk ka asnjë lëvizje në atë hapësirë. Sa i përket gurëthyesve në komunën e Klinës, inspektori i mjedisit vazhdimisht del në teren dhe i monitoron për licenca dhe dokumente të tjera. Ata janë kompetent.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Operatori për të cilin ka pyetur Zaferi duhet që të hulumtohet dhe të i gjendet emri e të ju dërgohet të gjithë asamblistëve. Kompetencë për licencimin dhe operimin e operatorëve është komisioni i pavarur për miniera dhe minerare. Ne mund të marrim informata, dërgoj inspektorin dhe marrim atë informacion dhe nuk do të presim seancën e ardhshme por menjëherë do të jua dërgojmë informacionin.

z. Zafer Gashi, disa herë ndërhyne gjatë fjalës së kryetarit dhe drejtorit të inspektoratit duke sqaruar edhe një herë se ku gjendet gurthyesi dhe duke thënë se në tabelë shkruhet “Çeku”.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Unë e kam hulumtuar gjithë dokumentacionin dhe konstatoi që nuk ka marrë licencë operatori që u përmend. Ai operon pa licencë. Ai operator ka marr një leje për rrymë, asgjë më shumë. Në lidhje me procesverbalin dhe takimet e operatorit me qytetarë nuk është kompetencë e Komunës.

z. Zafer Gashi: Ka dokument ku shkruhet se takimi duhet të mbahet në objektin e komunës dhe komuna ka obligim që të lajmëroj qytetarët.

z. Fadil Gashi, kryesues: Jo nuk ka. Nuk është e involvuar Komuna, se të ishte ashtu do të ishte shumë mirë ngase ne që tani do të i ndalonim ata operator.

z. Tunë Dedaj: Kam një kërkesë për drejtorin e urbanizmit por fillimisht dua ta falënderoj që është bërë një trotuar i shkëlqyer nga Deiqi deri në Zajm, me drunjtë dekorativ por duhet gjetur zgjidhje për ujitjen e tyre sepse do të dështojnë.

z. Kolë Prenaj: Sa e dijë unë punëtorët e mirëmbajtjes janë me kontratë dhe kërkoj që të gjendet mundësia e zgjidhjes së marrëdhënies së tyre të punës, kontratë të përhershme pasi që janë njerëz të specializuar dhe dinë të punojnë.

Pas mbarimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi z. Fadil Gashi shpalli të mbyllur mbledhje e kuvendit duke falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë.

Procesmbajtës:
Skënder Behramaj

Kryesuesi:
Fadil Gashi

Kuvendi Komunal - Klinë	
Pranuesi: [Blank]	
Data: 26.07.2024	
Kërkesë	
Për Ndihmë Financiare -	
01 353-23529/2024	

Paraqitësja e kërkesës: [Redacted] Qeskovë K. Klinë, Nr.tel [Redacted]

Sinqerisht më duhet të deklaroj se jetoj në një familje 5 anëtareshe. Jetojmë në një gjendje të rëndë ekonomike pa asnjë te ardhur. Qka e rëndon edhe më shumë barrën si dhe vështirëson mundësinë e mbijetesës për ne si familje është edhe paraqitja e sëmundjes serioze tek [Redacted] e cila është diagnostifikuar me sëmundje të rëndë të **Tumorit ne Stomak**. E si rezultat i kësaj është dashur të nënshtrohet një operimi qka ka rezultuar me sukses, mirëpo e njëjta duhet trajtohet vazhdimisht tek mjekët e ndryshëm specialist jashtë shtetit ne Shkup – Sistinë. Për qka akoma është nën përcjellje të ndonjë anëtari të familjes. Operimi i vajzës kap vlerën prej 11,900 euro, shumë kjo e pa përballueshme për ne si familje andaj me është dashur të huazoj nga disa te afërm Familjar. Jeta ime po bëhet qdo ditë dhe më e vështirë pasi që me shumë vështirësi arrijmë të sigurojmë parat për blerjen e medikamenteve apo dhe për vizitat në spitale, e lere me te arrij te kthej borgjin qe kam marre për shërim te vajzës. Jam në një gjendje të rëndë Financiare.

Unë nuk kam pronë time të trashëguar apo çfarëdo qoftë tjetër mbi vete, jetoj në një gjendje të rëndë ekonomike, e qka më sjellë edhe para sfidave të mëdha sociale.

Andaj kërkoj nga institucioni i lartcekur që të marrë parasysh kërkesën dhe nevojën time urgjente dhe të na bën një zgjidhje duke më ndihmuar financiarisht per kthimin e borgjit te cilin e kam marr per shërimin e vajzës time Menesës.

- Me Përgjegjësi të lartë morale deklaroj se jetoj në kushte jo të mira ekonomike.

Provë:

- Letërnjoftimi kopje.
- Deklarata e bashkësisë Familjare.
- Raportet mjekësore.
- Vërtetimi i papunësisë
- Numri i xhirologarisë bankare

Prandaj po i drejtohem titullit të lartëcekur, që të merr parasysh kërkesën dhe nevojën time urgjente.

Mbes me shpresë se kërkesa ime do të hasë në mirëkuptimin tuaj dhe të më gjendet zgjidhja për kthimin e borgjit qe ka marr per shërimin e vajzës, dhe blerjen e Medikamenteve mjekësore që më nevojiten për trajtimin e kësaj sëmundje.

Pejë 24.07.2024

Parashtruesi i kërkesës:

[Redacted Signature]

—

—

—

—

PËR: Kryetarin të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj.

KOPJE: Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Klinës, z. Fadil Gashi.

24.07.2024

LËNDA: Kërkesë për implementimin e ndërtimit të dy ashensorëve në hyrjen A dhe B, në objektin afarist banesor "Raffi", në rrugën "Abedin Rexha", përballë postës në Klinë, -

01-360-2325/24

Kërkojmë nga Komuna e Klinës, nga kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, si dhe kompetentët e tjerë për çështje ndërtimore që të na ndihmoj financiarisht në realizimin e ndërtimit të dy ashensorëve në hyrjen A dhe B, në objektin afarist banesor "Raffi" P+6 në Klinë, për arsye se objekti në fjalë është një ndër objektet e para të ndërtuara pas luftës në Komunën e Klinës dhe nuk posedon ashensor. Objekti është gjashtë katësh dhe për banorët vazhdimisht krijohen probleme për lëvizjen e tyre dhe bartjen e gjërave për jetesë dhe të paisjeve të ndryshme të nevojshme për banorët e këtij objekti. Përndryshe në objektin e tillë edhe komuna e ka pjesën e vet të pronësisë afariste dhe banesore dhe ka pra interesin e rregullimit të ashensorve përkatës.

Sqarojmë më tej se edhe Kuvendi i Komunës kohë më parë kishte miratuar një kërkesë tonën dhe projektin e tillë e kishte futur në listën prioritare të projekteve që do realizoheshin në vitin 2024.

Kërkojmë nga komuna që të na ndihmoj financiarisht dhe në aspektin urbanistik ngase nevojitet një renovim në katin e parë ku fillon ashensori, duke u nisur edhe nga fakti se objektet mbi 4 kate edheashtu ligjërisht do duhej të kenë ashensorët adekuat. Po sqarojmë edhe atë se të gjithë banorët në pamundësi që komuna ta mbuloj të gjithë pjesën financiare do të jemi të gatshëm të participojmë me vlerat adekuate sipas mundësive tona buxhetore.

Mbesim me shpresën që kërkesa jonë do të realizohet në tërësi!

Nënshkrimet e banorëve të objektit:

Nr. rendor:	Emri dhe mbiemri:	Nr. personal i letërnjoftimit:	Nënshkrimi:
1.	Rexhep Veseli	[Redacted]	[Signature]
2.	ALI SHALLA	[Redacted]	[Signature]
3.	Elmi Dushi	[Redacted]	[Signature]
4.	Uptoniut Jorolaj	[Redacted]	[Signature]
5.	Haxhi Metaj	[Redacted]	[Signature]
6.	Ismet Hoti	[Redacted]	[Signature]
7.	Isak Thaqi	[Redacted]	[Signature]
8.	ARBEN LIMAJ	[Redacted]	[Signature]
9.	Hagji Dragidella	[Redacted]	[Signature]
10.	Emine Paj	[Redacted]	[Signature]
11.	Lumirig Rama	[Redacted]	[Signature]
12.	ELVIJE GASHI	[Redacted]	[Signature]
13.	Alfred vesel	[Redacted]	[Signature]
14.	ISMET RASHIT HYSENI	[Redacted]	[Signature]
15.	Fejmiri Dragidella	[Redacted]	[Signature]
16.			
17.			
18.			

KUVENDIT KOMUNAL NË KLINË

REPUBLIKA E KOSOVË

ZYRËSË SË KRYETARIT TË KOMUNËS, z. Zenun Elezi

DREJTORISË SË BUJQËSISË NË KOMUNËN E KLINËS

NGA: [Redacted] me nr. [Redacted] nga fsh. Jashanicë K. Klinë

Klloka orig. Udh. Org./H. J. 2.	LËNDA: K Ë R K E S Ë
---------------------------------------	----------------------

-Për Kompensim të dëmëve, të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (Dëmi i shkaktuar nga Insektet)

Parashtruesi thekson se: jeton ne kushte tejet të veshtira ekonomiko-sociale dhe nuk ka asnjë burim te të ardhurave nga të cilat do mund të sigurohej mireqenja për jetën e tij dhe të familjes.

Andaj së fundi nga fatkeqësit natyrore më është bërë dëmë i lartë nga Insektet, të cilat kanë pushtuar e gjithë fshatin Jashanicë, Insektet më kanë dëmtuar Pemët, Perimet, gjelbrimin në oborr, si dhe Fasaden e Shtëpisë, e gjithë ky dëmë i shkaktuar nga Insektet, të cilat ditë më pare kanë pushtuar fshatin Jashanicë, tani për rigjenerimi të gjithë atij dëmi të shkaktuar parshtruesit të kërkesës po i kushton një shumë e lartë financiare.

Andaj, edhe është hera e pare që po kërkoj me shkrim nga Komuna e Klinës që të më mbështetni apo përkrahni në Kompensim të dëmeve të shkaktuara, që të bëjë Renovimin e Fasadës së shtëpisë, si dhe të i mjelli sërish Pemët dhe Perimet e dëmtuara nga insektet, andaj ju PROPOZOHET që të merrni në shqyrtim urgjent kërkesën e time, për kompensim të dëmëve të shkaktuara nga INSEKTET-fatkeqësi natyrore.

Duke u bazuar në të thënat e lartëcekuar dhe bazuar në gjendjen e rëndë ekonomike apo pamundësin për të rregulluar apo renovuar Fasaden e Shtëpisë, si dhe për ti Rigjeneruar Pemët, Perimet dhe Gjelbërimin e dëmtuar, parashtruesi i kërkesës KËRKON nga organet administrative të lartcekura, që të ja ofroni një mbështetje momentale-financiare apo Kompensim të dëmëve të shkaktuara nga Insektet-Fatkeqësi natyrore .

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, shpresoj të më aprovohet kërkesa ime !

Klinë, dt.05.07.2024

Parashtruesi i kërkesës:

Atulaj

[Redacted Signature]

—

—

—



Njësit. org.
Un.
Organ. Jed.

UDHËHEQËS
TITULLI
KATEGORIA

27.08.2025

Jeta
punt
Inest



01 360-2889570

NDIHMJA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas-Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoć
Agency for Free Legal Aid

KOMUNËS SË KLINËS

PËR: ZYRËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS SË KLINËS z.Zenun Elezi *po M. Elezi*

LËNDA: KËRKESË –për Subvencionim të Qeras së Banesë, në vlerë të 2000 deri në 2500 euro, për vitin 2024

[REDACTED] me vendbanim në Klinë, rruga "Abedin Rexhe" K.Klinë, Viktimë e Dhunës në Familje, parashtron këtë:

046 806-788

KËRKESË

Parashtuesja e kërkesës deklaroi se aktualisht është e shtyrë në moshë dhe nuk po mundet të gjenë ndonjë Strehim të qëndrueshëm dhe afatgjatë pa pagesë, po ashtu thekson se nuk ka as të mira materiale dhe as financiare, andaj po kërkon të ja mundësoni një Subvencionim të Qeras së Banesës ku është duke banuar, pasi që është hyrë edhe borgj ndaj Qeradhënësit të banesës që I ka siguruar Strehim parashtrueses së kërkesës, për arsye se nuk posedon as pronë dhe jeton me Qera aktualisht, andaj kosnideron se aktualisht është në gjendje të rëndë emocionale, financiare, dhe nuk po ka mundësi të siguron Strehim të qëndrueshëm.

Prandaj po ju drejtohem me këtë kërkesë në bazë të nevojës urgjente, për arsye se jam Viktimë e Dhunës në Familje, dhe po jetoj me vështirësi të mëdha dhe me pamundësi për të gjetur një Strehim të përherëshëm.

[REDACTED] jetoj në kushte tejet të veshtira ekonomiko-sociale dhe shëndetësore dhe nuk kam asnjë burim të të ardhurave nga të cilat do mund të sigurohej mireqenje për jetën time dhe të dy fëmijëve të mi, të cilët janë në shkollim, andaj po kërkoj të më merrni parasysh dhe të më ofroni ndonjë mundësi të Subvencionimit të Qeras së banesës ku aktualisht jam e strehuar.

Parashtruesja e kërkesës që disa vite kërkon ofrimin e të drejtës së Strehimit të përherëshëm, për arsye se më nuk mund të kthehet në Shtëpinë e bashkëshortit të saj, pasi që ka pasur dhunë të vazhduar. Vërtetohet se Komiteti për Politikë dhe Financa në Komunën e Klinës, ka nxjerrë një letërrekomandim ndaj kërkesës së [REDACTED], dhe ka kërkuar të merret parasysh nga organet administrative komunale, mirëpo për fat të keq të [REDACTED] ende nuk ju ka ofruar mbështetje e duhur apo nuk ju ka siguruar një Strehim i kësaj familje.
